

Të nderuar e të vlerësuar,

Meqë në shkrimin tuaj të djeshëm me titull “UP-ja pengon avancimin e një gruaje që mori më së shumti pikë nga komisioni vlerësues i FShMN-së” më keni përmendur edhe emrin tim, kërkoj nga Ju që ta publikoni reagimin tim ndaj këtij shkrimi. Reagimin tim, përveç në rrjetin social Facebook, mund ta gjeni edhe këtu, më poshtë:

Reagim ndaj shkrimit të [KALLXO.com](https://www.kallxo.com) me titull “UP-ja pengon avancimin e një gruaje që mori më së shumti pikë nga komisioni vlerësues i FShMN-së”

Meqë para disa kohësh, ne redaksinë e [KALLXO.com](https://www.kallxo.com) kam deponuar të gjithë dokumentacionin e protokoluor që ka të bëjë me zgjedhjen e një asistenti në Universitetin e Prishtinës — konkursi për pozitën nr.26 (FShMN), duke përfshirë edhe dokumentacion që katëçipërisht e vërteton mashttrimin që po i bëhet Universitetit të Prishtinës, në shkrimin e djeshëm të këtij portali, edhe pse më është përmendur emri im, fatkeqësisht nuk vëreja që është marrë diçka për bazë nga ato që kam deponuar! Për këtë arsye, më lejoni që të bëj reagimin tim në disa prej pikave kyçe që kanë të bëjnë me vlerat e mirëfillta në një universitet publik që paguhet nga taksat tona.

Eh, platformat indeksuese shkencore! Janë shumë të rëndësishme, por edhe të “rrezikshme”!

Platformat indeksuese shkencore janë ruajtësit e lavdisë së shkencës!

Platformat indeksuese shkencore janë ruajtësit e mendimeve të shkencëtarëve!

Platformat indeksuese shkencore janë bibliotekat e shkencës e shkencëtarëve!

Platformat indeksuese shkencore janë enciklopeditë e shkencës!

Platformat indeksuese shkencore janë prokurorët e heshtur të shkencës!

Platformat indeksuese shkencore janë gjykatësit e heshtur të shkencës!

Platformat indeksuese shkencore janë heronjtë e shkencës!!!

Si ka mundësi që anëtarët e Këshillit të Etikës të mos dinë t’i përdorin/kuptojnë platformat indeksuese shkencore? Mjerim për Universitetin e Prishtinës! Nëse e kanë bërë nga mosdija, shumë keq! Nëse e kanë bërë me vetëdije, edhe më keq!

Deri kur do ta lejojmë këtë analfabetizëm shkencor në Universitetin e Prishtinës?! Deri kur do ta lejojmë këtë korrupsion në Universitetin e Prishtinës?! Deri kur do ta lejojmë këtë degjenerim në Universitetin e Prishtinës?! Deri kur do ta lejojmë këtë shfrenim në këtë Universitet?!

E them me përgjegjësi të plotë morale, etike, shkencore e juridike se punimi shkencor me titull “Challenges of Soil Resource Protection: A Case Study from Sitnica River Basin (Kosovo)”, për herë të parë është publikuar më datë 20.05.2019 me autor korrespondent kryetar in e komisionit vlerësues, Ibrahim Ramadani. Saktësisht, më datë 09.05.2021, në orën 08:55, ndërrohet autori korrespondent, nga Ibrahim Ramadani në Tropikë Agaj.

U kërkoj ballafaqim publik — në cilëndo medie — kujtdo që dëshiron të jetë pjesëmarrës, përmes të gjitha strukturave të Universitetit të Prishtinës, e deri te kandidatët në këtë konkurs, për këtë degradim

moral e etik që po i bëhet këtij Universiteti, në lidhje me keqpërdorimin e punimeve shkencore për emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik.

Kryetari i komisionit vlerësues, Ibrahim Ramadani, në konkursin për emërim, riemërim dhe avancim të personelit akademik të UP-së nr. 2/872, datë: 22.10.2019 — FSHMN nr. 19, e përdor të njëjtin punim, në të cilin është autor korrespondent, për t'u avancuar nga titulli akademik profesor i asocuar në profesor të rregullt.

Anëtari i këtij komisioni vlerësues, Valbon Bytyqi, më datë 09.05.2021, në orën 08:55, i kërkon kryeredaktorit të revistës shkencore Journal of Ecological Engineering që ta ndryshoj autorin korrespondent, nga Ibrahim Ramadani në Tropikë Agaj. Për një gjë të tillë, kandidatja e tyre e preferuar i fiton 10 (dhjetë) pikë!

Si na qenka e lejueshme që veç pse i takon gjinisë femërore mund të paraqesësh si të vërtetë diçka të gënjeshtërt?! Veç pse i takon gjinisë femërore mund të ndërrosh a ndryshosh autorin korrespondent për të mashtruar të tjerët?!

Një grup i profesorëve të Departamentit të Gjeografisë vendosin që t'i bojkotojnë 2 (dy) mbledhje radhazi të këtij departamenti — në mesin e tyre edhe prof. Valbon Bytyqi. Kjo bëhet në mënyrë që mua të mos më aprovohej mbrojtja e temës së diplomës master me kohë. Një gjë të tillë mund ta vërtetoni duke i parë procesverbalet e mbledhjes së Departamentit të Gjeografisë së datës 28.04.2021 dhe 05.05.2021. Këtë e bëjnë që të fitojnë në kohë duke më pamundësuar të aplikoj në konkursin që do të hapej, për çka ju kam shkruar letër prej ministres së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Informacionit — e me të edhe rektorit të UP-së — e deri te niveli i Departamentit të Gjeografisë. Unë, konsideroj që ka dyshime të bazuara se ky veprim ishte i qëllimshëm! Kjo ngase unë, në studimet bachelor kisha notë mesatare 9.22, në krahasim me kandidaten e preferuar, e cila kishte notë mestare 9.17. Ndërsa, në studimet master, unë kisha notë mesatare 9.54, në krahasim me kandidaten e preferuar, e cila e kishte notën mesatare shumë më të ulët, 9.15. Jo vetëm dallimi në notën mesatare, por edhe kohëzgjatja e studimeve të masterit te kandidatja e preferuar e tyre ishte më e gjatë sesa që duhet, ndërsa unë e kisha përfunduar me kohë! Por, përveç kësaj, unë isha edhe autor i shumë punimeve shkencore të publikuara në revistat e indeksuara në Scopus dhe Ęeb of Science, e që ishte informatë e mjaftueshme që të bojkotoheshin mbledhjet, në mënyrë që të mos diplomoj me kohë! Gjithashtu, isha bursist i pesëfishtë dhe i shpërblyer me mirënjohje "Student i Dalluar".

Në këtë shkrim të publikuar dje nga KALLXO.com, vërejtja që njëri nga anëtarët e komisionit vlerësues, Valbon Bytyqi, qenka vetëlavdëruar e krekosur se në moshën 37 vjeçare i paska 5 (pesë) publikime shkencore! Por, çka të them unë që jam 24 vjeçar, e që si student i tij kam gjithsej 7 (shtatë) punime shkencore të publikuara në revista shkencore ndërkombëtare, të indeksuara në Scopus dhe Ęeb of Science, dhe 3 (tri) të tjera të cilat janë në fazën e publikimit?! A nuk janë këto informata të mjaftueshme që të tregojnë për kualitetin e individëve të caktuar në shkencën e gjeografisë në krahasim me moshën?

Më lejoni t'ju informoj se punimi im shkencor i publikuar nga shtëpia botuese më prestigjioze në botë — Springer Nature, është i vetmi publikim shkencor i botuar nga një shtëpi e tillë botuese në Departamentin e Gjeografisë (Universiteti i Prishtinës)!

Degradimi i Universitetit të Prishtinës përmes krijimit të standardeve të dyshimta profesionale-shkencore, duke lejuar ndërrimin e rëndësisë së autorëve në punim sipas interesave personale, në kohë të ndryshme, dhe sipas nevojës; dhe e njëjta të përkrahet nga njerëzit brenda dhe jashtë Universitetit të Prishtinës, krijon një fushë të gjerë të aktiviteteve primitive dhe vetëshkëtruese! Një universitet, i cili u ka qëndruar sfidave të shumta të kohës, nuk e meriton që nga gjeneratat e reja dhe grupet e interesit të kthehet në një universitet të nivelit të shteteve më të pazhvilluara afrikane!

Unë, besoj fuqishëm që menaxhmenti i Universitetit të Prishtinës dhe Senati nuk do lejojnë që standardet e tilla joprofesionale të vendosen në Universitetin e Prishtinës. Meqë me një kërkim të thjesht mund të vërtetohet se kryetari i Këshillit të Etikës nuk e ka as edhe një (1) punim të vetëm shkencor të indeksuar në Scopus, si është e mundur që vendimi i nënshkruar prej tij të jetë kredibil dhe vendimmarrës?! Anëtarët e Këshillit të Etikës duhet t'u nënshtrohen një skanimi profesional, por edhe të njohurive mbi standardet bashkëkohore të platformave indeksuese të revistave shkencore ndërkombëtare, në mënyrë që të konstatohet qëllimi i nxjerrjes së vendimeve të tilla skandaloze!

Me shpresën që Universiteti i Prishtinës nuk do të dorëzohet kundrejt këtyre mashtrimeve të bëra me punime shkencore, me mburrje do ta mbajë diplomën e fituar në po këtë Universitet!

Albert BERILA

Prishtinë, 04.01.2022